

VENDIM
Nr.879, datë 3.11.2010

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.138, DATË 14.3.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PROCEDURËN E TRAJTIMIT TË ARMËVE, TEKNIKËS DHE
PAJISJEVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË HEQURA NGA ARMATIMI DHE
PËRDORIMI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të pikës 1 kreut II të vendimit nr.138, datë 14.3.2007 të Këshillit të Ministrave, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Përjashtohen nga çmilitarizimi të gjitha llojet e kapsollave, fitilave plasës, ndezësit dhe zjarrpërcjellësit, dinamitet dhe amonitet.”.

2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha